

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, përmes gjyqtarit të vetëm Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Syla, në çështjen penale kundër të pandehurit, V. T., për shkak të veprës penale, asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 i KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore, Departamenti për Krime të Përgjithshme në Gjilan dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor,(PTHDP),PP.II.nr.69/17,e dat. 20.01.2017, më 07.06.2017, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH në Gjilan, PP.II.nr. 69/2017 e dat. 20.01.2017 për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit,

V. (J.) T., i lindur më ... në fsh. M., Komuna e Gj., tani me vendbanim në Gj., rr. '...', puntor, shqiptar, me numër të tel. ..., shtetas i Republikës së Kosovës.

ë s h t ë f a j t o r

Sepse, më datë ..2016 në intervalin kohor ... minuta, në rrugën e '...' në Gj., i pandehuri me dashje ka shkaktuar dëm material të dëmtuarit Sh. Y., në automjetin e tij '...' të parkuar në afërsi të shtëpisë së tij, në atë mënyrë që ka tentuar me forcë fillimisht ta hap derën e pasagjerit dhe me atë rast dëmton bravën e të njejtës, për ta larguar nga ky vend-parkim, dhe në pamundësi që ta largoj këtë automjet,e then dritaren e pasme të veturës në anën e majtë, duke i shkaktuar të dëmtuarit dëm material në vlerë të pa përcaktuar.

Me çka ka kryer veprë penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 i të KPRK-së.

Andaj gjykata bazuar në dispozitën e sipërtheksuar ligjor, si dhe neneve 4, 41, 46, 73, 75, dhe 76 të KPRK-së, e në lidhje me nenin 365 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehurin e

Me dënim me gjobë në shumën prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë) Euro, të cilën gjobë i pandehuri, i lartëcekur do t'a arkëtoj në afat prej 3 (tre) muajve ,nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mundet, që t'a arkëtoj dënimin me gjobë, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 €, të dënimin me gjobë do t'i llogaritet me një ditë burgim.

Detyrohet i pandehuri që t'a arkëtoj paushallin gjyqësor, në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

I dëmtuari, Sh. Y. nga fshati Ll., Komuna e Gj., për realizimin e kërkesave pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

PTH-Departamenti për Krime të përgjithshme në Gjilan, ka ngritur aktakuzë, PP.II.nr. 69/17 e dat. 20.01.2017, me kërkesën e urdhërit ndëshkimor, që ndaj të pandehurit V. T. nga Gj., për shkak të veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-së, PTH ka kërkuar që të pandehurit t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë, sipas nenit 493 paragrafi 1 të KPPRK-së

Gjykata, pasi shqyrtoi, aktakuzën e PTH në Gjilan me kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor si dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e PTH për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit të lartëcekur dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënimi me gjobë.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura edhe atë numri i rastit ... i datës ...2017, deklarata e të dëmtuarit, deklarata e dëshmitarit dhe e të pandehurit, raporti i oficerit i dt ...2016, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor me bindje se edhe ky dënim i shqiptuar do të ndikojë pozitivisht te i pandehuri dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimin nga neni 41 të KPPRK-së, prandaj e miratoi kërkesën e PTH nga Gjilani dhe të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi urdhër ndëshkimor - dënimin me gjobë në shumën si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Konform nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së , i dëmtuari Sh. Y. nga fsh. Ll., Komuna e Gj., për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Nga të cekurat si më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN- DEPARTAMENTI I
PËRGJITHSHËM
P.nr. 62/2017, më 07.06.2017**

Sek.Juridike:
Rafete Syla d.v

G j y q t a r i:
Islam Thaçi.d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi- urdhëri ndëshkimor mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimet të të njëjtit. Kundërshtimi i dorëzohet kësaj gjykate.